

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pas ikjes së Edi Ramës, PS përfundon si PD-ja e Lulit dhe e Berishës!
ADRESA	https://kohajone.com/kryesore/pas-ikjes-se-edi-rames-nga-drejtimi-i-ps-a-mund-te-perfund-oje-ps-ja-si-pd-ja-e-lulit-dhe-e-berishes/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 10:29:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 21:55:36 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	cdf1c49a635279f11b5f9bec91bfe9c67563077bb5d8b873de1529195d22559d
TEKSTI	dfcc6c331b00099e82fdf843a012bbd212049b336eb522e49fb7212dacec5a2c
PAMJA	12884b3c61971a9457da96c34a26c949abd59790147557d7e84bd5d664d2f8f9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3004156835ef37a06249f0848dee236a587b1d2a5248cfaa4cc2f0d8b8946e7b
E MËPARSHMJA	27f2bb20e68acfedadc5178352bd16b98c8bd12913843d44f8c49dfe2656ecb9
RRËNJA MERKLE	8753ce540c62032b2d2e93a89d04bff23ee77373840327f812029eb4b6321ed5
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3004156835ef37a06249f0848dee236a587b1d2a5248cfaa4cc2f0d8b8946e7b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

 [LEXONI LAJMET E FUNDIT](#)

 [KOHA JONË NË FACEBOOK](#)



 [KOHA JONË NË INSTAGRAM](#)

 [KOHA JONË NË YOUTUBE](#)

[E përditshme e pavarur](#)

- [LAJME](#)
- [SPORTI](#)
- [EKONOMI](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [AKTUALITET](#)
- [KOSOVA](#)
- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [WEBTV](#)

- [MË TË FUNDIT](#) 

- [LAJME](#)
- [SPORTI](#)
- [EKONOMI](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [AKTUALITET](#)
- [KOSOVA](#) 
- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [TEKNOLOGJI](#)
- [SHËNDETI](#)
- [EDITORIAL](#)
- [WEBTV](#)

-  [Facebook Icon](#)
-  [Instagram Icon](#)
-  [YouTube Icon](#)

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991

Botues: **Nikoll LESI**. Adresa e redaksisë: Rruga "Sami Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

[NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA](#)





[E përditshme e pavarur](#)

- [LAJME](#)
-  [EURO24 Logo WEBTV](#)
- [SPORTI](#)
- [EDITORIAL](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [AKTUALITET](#)
- [EKONOMI](#)
- [KOSOVA](#)
- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [KULTURA](#)
- [TEKNOLOGJI](#)
- [SHËNDETI](#)

Pas ikjes së Edi Ramës, PS përfundon si PD-ja e Lulit dhe e Berishës!

[Kryesore](#) E Diel, 6 Shtator 2026 23:55



Edi Rama ka bërë për herë të parë një deklaratë të qartë për trashëgiminë politike në Partinë Socialiste. Ai tha prerë: Nuk do të zgjedhë dhe as të emërojë pasardhësin e tij.

Në paralajmërimin për rikthimin e podkastit "Flasim", ku këtë herë do të jetë ai përballë pyetjeve, Kryeministri shprehet: **"Ai që të sfidon dhe bëhet pasardhës, ai duhet të të vrasë. Unë personalisht nuk kam ndërmend të zgjedh pasardhës. Në momentin që unë do të kaloj pranun e asaj dere, do të shpëtoni nga unë".**

 [Koha YouTube Channel](#)

Natyrisht, Rama flet për një "vrasje" politike: pasardhësi nuk duhet të caktohet nga kryetari, por duhet të ketë forcën, autoritetin dhe mbështetjen për ta marrë vetë drejtimin.



Në parim, Edi Rama ka të drejtë. Partia Socialiste nuk është pronë personale që kryetari t'ia lërë me testament njeriut të tij të preferuar. Pasardhësi i një lideri nuk duhet të emërohet në zyrë, të prodhohet me dekret apo të vendoset si trashëgimtar familjar. Ai duhet të fitojë garën politike brenda partisë. Por deklaratat e Ramës ngre një pyetje shumë më të madhe: A ka lënë ai brenda Partisë Socialiste hapësirën e nevojshme që të lindë dhe të forcohet një pasardhës?



Pas më shumë se dy dekadash në krye të PS-së dhe pas katër mandateve qeverisëse, rreth Ramës nuk është konturuar ende një figurë e dytë politike me autoritet të plotë, profil kombëtar dhe mbështetje të veten në parti. Ka ministra të rëndësishëm, drejtues politikë dhe njerëz me pushtet, por nuk ka një numër dy të padiskutueshëm.

Dhe kjo nuk është rastësi.

Liderët e fortë në Shqipëri kanë prirjen të mos lejojnë rritjen e një figure që mund t'i sfidojë. Ata duan bashkëpunëtorë të fuqishëm përballë kundërshtarëve, por të dobët përballë kryetarit. U japin poste, por jo autoritet të pavarur. U japin pushtet administrativ, por jo hapësirën politike për t'u kthyer në alternativë.

Këtë problem e kanë si Partia Socialiste, ashtu edhe Partia Demokratike. As Edi Rama dhe as Sali Berisha nuk kanë lejuar të konsolidohet qartësisht një numër dy, i cili mund të marrë drejtimin dhe të

garantim të pavarshmërisë së palos për burgim të murt...

Rama thotë se ai që është i zoti duhet ta marrë vetë PS-në. Kjo tingëllon demokratike, por gara duhet të jetë reale. Nuk mund t'i kërkes dikujt të bëhet pasardhës, nëse për vite me radhë çdo shenjë autonomie është parë si tradhti dhe çdo ambicie personale si kërcënim ndaj kryetarit. Një parti moderne duhet të prodhojë disa figura të forta, jo vetëm një lider të pakonkurueshëm. Duhet të ketë debat, rryma, alternativa dhe, pse jo, edhe fraksione të njohura. Vetëm kështu pasardhësi del nga gara dhe jo nga zarfi i mbyllur i kryetarit.

Nëse Rama largohet një ditë pa lënë pas një mekanizëm demokratik gare, rreziku është që në PS të shpërthejë një luftë e ashpër mes grupeve për pushtetin. Blendi Klosi do mbetet me vulën e PS në xhep pa e ditur se kujt t'ia jap. Pandeli Majko do vijë të flasë si Hrushovi për Stalinin! Erion Veliaj me duart me vranga nga prangat do të thotë se “takon mua PS se bëra burg si Fatos Nano”! Elisa Spiropali do publikojë testamentin e ri politik, prodhuar nga chatgpt. Ditmir Bushati do ngrihet në podium e do të thotë se “PS duhet të kthehet në gen, të unë”. Gramoz Ruçin nuk do ta lënë të futet në Kongres. Ben Blushi do ta ndjekë nga lart e nga larg rrëmujën e pasepokës Rama.

Atëherë nuk do të fitojë domosdoshmërisht më i zoti, por ai që kontrollon më shumë poste, deputetë, bashki, interesa ekonomike dhe mekanizma administrativë. Një kasapphanë do të plasi pas ikjes së Ramës në kupolën e PS.

Sidoqoftë Edi Rama ka meritën e padiskutueshme se e ka mbajtur Partinë Socialiste të bashkuar dhe e ka çuar në katër mandate radhazi, një arritje e paprecedentë në pluralizmin shqiptar. Por pikërisht për shkak të kësaj peshe të jashtëzakonshme, largimi i tij do të krijojë një boshllëk të madh. Prandaj nuk mjafton të thuhet: “Nuk do të zgjedh pasardhës”.

Rama nuk duhet të caktojë një trashëgimtar, por ka detyrimin politik të lërë pas një parti ku pasardhësi mund të zgjidhet lirisht. Të mos kurorëzojë një emër, por të garantojë një garë. Të mos lërë një princ të emëruar, por rregulla demokratike që vlejnë njësoj për të gjithë kandidatët.

Në fund, drejtimin e PS-së duhet ta marrë ai që ka më shumë mbështetje, autoritet dhe aftësi politike. Jo ai që merr bekimin e fundit të Ramës dhe as ai që kontrollon më mirë administratën.

Deklarata e Kryeministrit është e fortë dhe, në thelb, e drejtë: pasardhësi nuk emërohet, por fitohet. Tani mbetet të shihet nëse Edi Rama do të lejojë që gara për pasardhësin të fillojë kur ai të jetë ende në zyrë, apo në PS do të guxojnë të ngrenë kokën vetëm pasi ai të ketë kaluar përfundimisht pragun e derës.

Në PS ka patur debate, fraksione, alternativa. Ishte Ben Blushi që deri më sot mbetet njeriu më me personalitet si konkurent i Ramës. Por u largua, kur e pa se nuk kishte hapesira mendimi ndryshe. Ishte edhe Sajmir Tahiri një konkurent me vonë. Por u palos! Hyri në burg. Doli Ditmir Bushati, por e shkarkuan. Edhe Erion Veliaj u bë gati ta merrte, por ndodhet në qeli! Kishte deputetë pas zgjedhjeve të fundit që thonin se do të jetë Belinda Balluku, pas epokës Rama, por e masakruan. Flet Elisa Spiropali, por e kanë lënë përtej lumit. E kush ka mbetur tjetër? Është Fatmir Xhafa, politikan me personalitet, por nuk ndihet. Kurse Damian Gjiknuri do bërtasë: Kthehu Edi, kthehu! Erion Braçe do fërkojë duart e do turret bashkisë. Ulsi Manja do nxitojë të flasë në media se “shpëtuam nga Rama, shqyrr”. Oligarkët do festojnë me pije të shtrenjta dhe do darkojnë me Saliun 100 vjeçar se “erdhi koha e Doktorit”!!

Por Edi Rama ka të drejtë kur thotë: “Ai që të sfidon dhe bëhet pasardhës, ai duhet të të vrasë. Unë personalisht nuk kam ndërmend të zgjedh pasardhës...”. Sepse edhe vetë e mori, e fitoi, pasi Fatos Nano nuk ia dhuroi. Përkundrazi Nano donte dikë tjetër t'ia linte PS. Por Edi Rama ia mori. E fitoi!

/Spiten Prulli/

SHKARKO APP

[iPhone](#)
[Android](#)


A duhet liruar Erion Veliaj të drejtë bashkinë nga zyra?


☐ Po

☐ Jo


Voto

Shiko rezultatin

Më shumë nga Kryesore



Qëndrim institucional i mbledhjes së kryetarëve të Shqipërisë: Të zba...



[Sulmi ndaj deputetes së PS, Rama poston videon: Çfarë mjerimi mendor](#)



[SPAK dhe BKH hyjnë për kontroll në Parlament](#)




[A duhet një Pol i Tretë për të sfiduar PS-në dhe PD-në?](#)






[Pas kaosit tek Kuvendi, protestuesit bllokojnë Bulevardin: Nuk shitet...](#)




[Italia përjeton verën më të nxehtë që nga viti 1950, sipas të dhënave...](#)

[LAJMET E FUNDIT](#)




[Real Madrid e nis me fitore Championsin, mposht Interin në Bernabeo](#)

6 orë e 2 minuta më parë



[Qëndrim institucional i mbledhjes së kryetarëve të Shqipërisë: Të zbatohet urgjent Vendimi i Kushtetueses për pagat!](#)

6 orë e 59 minuta më parë



[12 vatra aktive, Ministria e Mbrojtjes informon për zjarret: Vijnë operacionet në disa qarqe](#)


7 orë e 3 minuta më parë

7 orë e 9 minuta më parë



Mbyllen pjesët e para në Champions/ Reali po mund Interin me dy “dhurata”

7 orë e 9 minuta më parë



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.